


### III.4.3. REAKSIONET E SHKËPUTJES TË LIDHJES C-OH NË ACIDET KARBOKSILIKE

Në mesin e reaksiioneve të shumta dhe të rëndësishme të acideve karboksilike janë reaksionet tek të cila vjen deri te **shkëputja e lidhjes C-OH, gjegjësisht deri te zëvendësimi i grupit hidroksil** me grupet tjera funksionale, Z. Prandaj, këto komponime me emër të përgjithshëm quhen **derivate funksionale të acideve karboksilike**. Varësisht nga ajo se me çka është bërë zëvendësimi, përfitohen derivate të ndryshme të acideve karboksilike si: **estere, anhidride, acil halogjenure dhe amide**.



### Derivate funksionale të acideve karboksilike




Prej derivateve të acideve karboksilike me rëndësi të madhe për nga aspekti biologjik dhe industrial janë esteret, prandaj do ti mësojmë më hollësisht. Këtu do të ndalemi më shkurtimisht për acil halogenuret, amidet dhe anhidridet e acideve karboksilike.

### Acil halogenuret

Acil halogenuret janë komponime në të cilat **grupi hidrosil i grupit -COOH të acidit është zëvendësuar me atom të elementit halogen**. Formula e përgjithshme e acil halogenureve (halideve) është:



Këto komponime përfitohen kur në acid veprohet me  $\text{PCl}_5$  ose  $\text{SOCl}_2$ .



Acil halogenuret emërtohen ashtu që, emrit të anionit halogenurit (klorur, bromur...) i shtohet baza e emrit që merret prej emrit të acidit përkatës, në të cilin prapashtesa –ik e acidit zëvendësohet me **–oil**. Te disa acil halogenure përdoren emrat trivial.

Për shembull:



**klorur etanoil** (klorur acetil).


Këto komponime janë substanca kalimtare të rëndësishme për një numër të madh të sintezave organike.

### Anhidridet e acideve karboksilike


*Anhidridet janë derivate te acideve karboksilike, tek të cilët grupi hidroksil është i zëvendësuar me grupin  $\text{RCOO}-$ .*

Këto komponime përfitohen nëse *prej dy grupeve karboksile të të dy molekulave te acideve (ose prej një molekule të acidit dikarboksilik) ndahet një molekulë ujë.*


Për shembull:




Në acidet dikarboksilike, uji veçohet prej të dy grupeve karboksilike të të njëjtës molekulë dhe krijohet unazë. Tek acidet aromatike dikarboksilike, për tu fituar anhidrid, grupet karboksile duhen të jenë në pozitat-o.



Anhidridet e acideve karboksilike emrën ashtu që, thuhet: anhidrid i acidit përkatës. Për shembull:



anhidrid i acidit acetik



anhidrid i acidit benzoik

## **Amidet e acideve karboksilike**

**Komponimet me formulë të përgjithshme  $RCONH_2$  (ose  $ArCONH_2$ ) quhen amidet e acideve karboksilike.**

Amidet emërtohen me zëvendësimin e prapashtesës –ik te acidet, me prapashtesën **–amid**. Në përdorim shpeshherë janë edhe emrat e amideve që nxirren prej emrit trivial të acidit. Për shembull:



Amidet e acideve mund të përfitohen me më shumë reaksione të ndryshme, prej të cilëve më i rëndësishëm është reaksiuni i acil klorureve me amoniak.



Amidet marrin pjesë në shumë reaksione të ndryshme. Këto hidrolizojnë në mjeshtëslik ose bazik, deri në acid karboksilik përkatës dhe amoniak.




## **Reaksionet tjera të acideve karboksilike**

Përveç dy llojeve kryesore të reaksiioneve të acideve karboksilike, ekzistojnë edhe disa reaksiione tjera, siç janë për shembull: reduktimi dhe dekarboksiliimi.

### **Reduktimi i acidve karboksilike**

Pamë se me oksidim të alkooleve dhe aldehideve përfitohen acidet karboksilike. Si pas kësaj, pritet që me reduktim acidet karboksilike të kalojnë në aldehyde, e pastaj edhe në alkool. Reduktimi i acideve karboksilike zhvillohet me mjete reduktuese speciale ( $LiAlH_4$ ). Kështu, gjatë reduktimit të acideve karboksilike alifatike përfitohen alkooli primare me numër të njëjtë të C-atomeve. Për shembull:



### **Pyetje dhe detyra:**

1. Shkruaj barazimin e reaksiionit për përfitimin e klorur propanoil-it.
2. Shkruaj barazimet kimike të reaksiioneve në të cilët mund të përfitohen:
  - a) anhidrid i acidit acetik dhe acidit benzoik
  - b) anhidrid i acidit formik dhe acidit acetik
  - c) anhidrid i acidit oksalik
3. Çka përfitohet gjatë reaksiionit të amoniakut me acidin benzoik? Shkruaj barazimin e reaksiionit.
4. Shkruaj barazimin kimik të reduktimi të acidit butanik.

Përgjigjet i dërgoni në e-mail adresën:  
[hafsa.selimi@hotmail.com](mailto:hafsa.selimi@hotmail.com) dhe do të fitoni përgjigje nga unë,  
përsaktësinë dhe josaktësinë e tyre.